**VENDIM**
**Nr. 171, datë 3.3.2016**

## PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 841, DATË 27.9.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË FINANCAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3, e kreut IV, të vendimit nr. 841, datë 27.9.2013 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Është përgjegjëse për hartimin e politikave për miradministrimin e buxhetit, në të cilat përfshihen: planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, programimi strategjik dhe monitorimi i investimeve publike, monitorimi i marrëdhënieve financiare ndërqeveritare, kontrolli financiar i transaksioneve publike dhe hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të qeverisë.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**